

PËRMBLEDHJE E DËGJESËS PUBLIKE

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale

Qarku Gjirokastrë | 24 Prill 2026

1. Konteksti dhe kuadri i dëgjesës

Dëgjesa publike e Gjirokastrës, e zhvilluar më 24 Prill 2026, shënoi sesionin e dytë konsultues të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale (RAT), menjëherë pas sesionit të parë të mbajtur në Lezhë. Ajo u organizua nën moderimin e Znj. Valbona Karakaci, Këshilltare Strategjike e projektit Bashkitë e Forta, financuar nga Ambasadat e Zvicrës dhe Suedisë.

Qarku i Gjirokastrës ka shtatë bashki: Gjirokastrë, Memaliaj, Këlcyrë, Përmet, Tepelenë, Libohovë dhe Dropull.

Sesioni i dëgjesës në Gjirokastrë, u strukturua rreth tre shtyllave të deklaruara të Komisionit, organizimi territorial, funksionet dhe kompetencat, si dhe financat vendore, me nga rreth 30 minuta për secilën, ndonëse kufijtë mes tyre ishin fluidë dhe diskutimi lëvizi natyrshëm ndërmjet dimensioneve. Takimi u transmetua drejtpërsëdrejti në kanalën e dedikuar të Kuvendit dhe u regjistrua plotësisht.

Karakteristika dalluese e këtij qarku

Gjirokastra është qark me identitet shumështrësor si historik (qendër administrative shekullore), kulturor (pjesë e UNESCO me mbi 1.000 monumente të kategorisë I dhe II), etnik (minoritet grek me prani të konsiderueshme) si dhe turistik (rreth 400.000 vizitorë të huaj në vit). Këto dimensionë e bënë debatin e Gjirokastrës dukshëm të ndryshëm nga ai i Lezhës: trashëgimia kulturore dhe identiteti u ngritën si argumente të vazhdueshme.

2. Organizimi territorial dhe qeverisja

2.1 Argumentet pro ruajtjes

Modeli i Gjirokastrës

Bashkëkryetari Boçi e hapi sesionin me tezën: qarku i Gjirokastrës, me shtatë bashki dhe popullsi mesatare rreth 7.000 banorësh, i afrohet standardit europian (6.000) dhe duhet të shërbejë si 'format' për reformën. Ky argument u ndërtua mbi premisën se numri i lartë i njësive dhe afërsia e tyre me qytetarin janë vlera strukturore, jo probleme administrative. Në këtë logjikë, nëse qarku i Gjirokastrës funksionon (me rezervat e tij), ky model mund të bëhet normë për reformën e re.

Largësia fizike si pengesë e pakapërcyeshme

Mësuesi Xhulian Xhaferaj, që punon në një fshat të bashkisë së Këlcyrës, paraqiti perspektivën ku sipas tij shërbimet janë përkeqësuar ndjeshëm nga ndarjet territoriale aktuale, duke

argumentuar jo vetëm ruajtjen e bashkive të vogla por edhe rikthimin e komunave. Ai e mbështeti argumentin e tij mbi krahasimin direkt se kur ishin komunat, shërbimi ndaj fshatit ishte më i pranishëm; sot, me bashki të mëdha, shërbimi ka largësi dhe vonesa. Ndërhyrja e tij evidentoi gjithashtu edhe dimensionin europian duke shtuar se edhe Europa ka komuna.

Identiteti komunitar

Tre bashki u mbrojtën me argumente specifike: Libohova (Arnisa Hide dhe Besnik Ismailati) ngriti potencialin ekonomik real ku 60%+ e territorit i përshtatshëm për bujqësi dhe blegtori, Kalaja si burim agroturizmi, diaspora si potencial investitor; Memaliaj (kryetari Albert Malaj) evidentoi dimensionin demografik dhe ekonomik lokal. Ndaj, heqja e bashkisë mund conte drejt tkurrjes së tregut të brendshëm të qytetit si kafenetë, furrat, shkollat duke përshpejtuar braktisjen. Ndërkohë, Dropulli u paraqit si rast veçanërisht i ndjeshëm me komunitet minoritar grek që kërkon trajtim të veçantë kushtetues.

Propozime konkrete të rishikimit territorial

Ish-anëtar i këshillit bashkiak Dashnor Aliko propozoi bashkëngjitjen e Lungjërisë dhe Antigoneas të Libovës, si dhe kthimin e Kardhiqit dhe Cepuës në njësi vendore të veçanta (me argumentin se sipërfaqja e tyre totale tejkalon atë të bashkive të konsideruara të mëdha);

2.2 Argumentet pro konsolidimit dhe stabilitetit territorial

Ekonomia e shkallës si argument pragmatik

Kryetari i këshillit të Bashkisë Tepelenë, Arben Gumeni, paraqiti argumentin financiar me shembullin më të drejtpërdrejtë: 'Sa më e vogël të jetë njësi, aq më pak lekë ke dhe aq më pak shërbime mund të bësh.' Ai kundërshtoi rikthimin tek njësitë e vogla me argumentin se bashkia e Tepelenës, edhe sot, nuk ka burime të mjaftueshme, dhe copëzimi i mëtejshëm do të agravonte situatën.

Kapacitetet administrative si kusht paraprak

Administratorja Mimoza Shëngjergji (NJ.Adm. Odrie, Bashkia Gjirokastrë), me 14 vjet eksperiencë në pushtetin vendor, evidentoi efektet pozitive të reformës: staf më i kualifikuar dhe administratë më profesionale, planifikim afatgjatë, shërbime më të standardizuara. Ajo argumentoi se bashkitë e mëdha arrijnë tërheqje fondesh nga donatorë dhe programe ndërkombëtare që bashkitë e vogla nuk do mund t'i aksesojnë.

Propozime konkrete të rishikimit territorial

Arben Gumeni propozoi për të gjithë Shqipërinë intervalin 12–36 bashki si numrin optimal ('mbi 36, na keni vrarë të tërë'), duke argumentuar bashkimin e disa ish-komunave nën bashki me kapacitet të mjaftueshëm financiar dhe administrativ. Ky propozim u ndodh mes dy pozicioneve ekstreme dhe tentoi të ndërtojë një qasje të mesme pragmatike.

Petrit Brahimi (anëtar Këshilli Bashkiak Gjirokastrë) propozoi reduktimin nga 7 në 4 bashki, duke lënë Dropullin të veçantë; kryetari i Bashkisë Memaliaj propozoi rishikimin e mundësisë së kthimit të 2-3 ish-komunave (si ish-komuna e Buzit me ~15 fshatra) si njësi rurale të pavarura.

2.3 Dimensioni rajonal: niveli i ndërmjetëm si pikë konvergjence

Rajonet dolën si çështje e patrajtuar por e domosdoshme dhe si pikë e rrallë konvergjence ndërmjet pozicioneve të ndryshme si mazhoranca dhe opozita. Ish-prefekti Odise Kote evidentoi se BE-ja i kishte kërkuar Shqipërisë rajonet që nga vitet 2000-2005, por iniciativa u la në mes. Ish-prefekti Spiro Ksera shtoi dimensionin demokratik: rajonet duhet të kenë kryetar të zgjedhur me votë nga qytetarët (modeli grek, italian, gjerman), jo të emëruara. Bashkëkryetari Boçi propozoi forcimin e qarkut të Gjirokastrës si rajon me kompetenca të vërteta, duke evidentuar absurditetin aktual: taksa e kalasë shkon te qeveria, ndërsa taksa e muzeut te bashkia.

3. Funkcionet dhe kompetencat

Seksioni i funksioneve dhe kompetencave prodhoi evidencën me vlerë analitike më të lartë. Gjirokastra si qark me shtatë bashki me profil shumëllojshëm evidentoi disa çështje specifike që nuk dolën po me këtë intensitet në Lezhë.

3.1 Kryetarët e bashkive me funksione të dobësuar

Diagnoza më e fortë konsensuale e dëgjesës ishte: disa funksione të kryetarëve të bashkive janë reduktuar. Kjo diagnozë u shpreh nga aktorë me pozicione të ndryshme politike dhe institucionale:

- Petrit Brahimi (anëtar Këshilli Bashkiak Gjirokastrë): kryetarët e bashkive merren me pastrimin e qytetit, ndriçimin, tek shëndetësia, arsimit nuk kanë akses.
- Arben Gumeni (kryetar Këshillit, Tepelenë): 'Jam bërë si kryetar, si drejtor komunales.'
- Kryetari Flamur Golemi (Bashkia Gjirokastrë) konfirmoi: kompetencat e deleguara pa burime financiare adekuate janë kompetenca boshe.

3.2 Shërbime specifike me problematika të evidentuara

Shërbimi shëndetësor parësor

Dashnor Aliko (ish-kryetar komunës Lazërat, anëtar Këshillit Bashkiak) evidentoi se qendrat shëndetësore në shumë fshatra mbyllen pas orës 10:00–11:00, pasi varen administrativisht nga ISKPSH-ja, jo nga bashkia. Ai propozoi ndarjen e qartë: administrimi (orari, prania) të jetë kompetencë e bashkisë; aspekti profesional (kontrolli i mjekëve) të mbetet i ministrisë. Mjekja Zhenisa Çuni (Universiteti i Gjirokastrës) propozoi modelin italian: rajonet të menaxhojnë fondet e shëndetësisë dhe të financojnë edhe kërkimin shkencor.

Bujqësia: fragmentim institucional sistematik

Petrit Brahimi (specialist bujqësie, anëtar Këshillit Bashkiak) paraqiti diagnostikën më konkrete të sesionit mbi sektorin bujqësor: veterineret varen nga Vlora, agronomët nga Lushnja, bordi i kullimit nga Fieri, mbrojtja e bimëve sërish nga Vlora. Ky fragmentim institucional, me të gjithë shërbimet kyçe bujqësore varur nga qytete dhe qarqe të tjera, e bën koordinimin e politikave bujqësore vendore praktikisht të pamundur.

Vaditja dhe kullimi: fusha e Gjirokastrës

Aliko evidentoi me shifra konkrete: fusha e Llazëratit ka 620 hektarë tokë, prej të cilave sot vaditen jo më shumë se 50 hektarë, pra rreth 8% e kapacitetit. Arsyeja: infrastruktura e kanaleve ujitëse dhe kulluese është praktikisht jooperacionale. Kjo situatë u paraqit si simptomë e mosfunksionimit të kompetencave vendore mbi bujqësinë.

Ujësjetësi: centralizim i debatuar

Kryetari Golemi shprehu mbështetje të kujdesshme ndaj decentralizimit të ujësjetësit drejt bashkive. Nga ana tjetër, një anëtar i këshillit bashkiak evidentoi të dhëna pozitive: nga 2023-i deri tani, treguesit e performancës së Shoqërisë Rajonale të Ujësjetësisë-Kanalizimeve janë dyfishuar (pagesa e pagave, sigurime shoqërore, energji elektrike, investime). Kjo kontestoi tezën e thjeshtë të ri-komunalizimit të shërbimit. Petrit Brahimi, nga ana tjetër, evidentoi mungesën e mjeteve: 'Kthehen kompetencat për pastrimin e kanaleve, por nuk ke mjete me se do pastrohen.'

Institucionet e larguara nga Gjirokastra

Pandeli Kuremeno (këshilltar Bashkia Dropull) kërkoi kthimin e institucioneve të zhvendosura nga Gjirokastra: gjykatave, drejtoritë bujqësore, institucione administrative. Kjo evidentoi një tendencë më të gjerë të centralizimit institucional të pavarur nga reforma territoriale, reforma e gjyqësorit, reforma e arsimit dhe riorganizimet administrative sektoriale kanë tkurrur prezencën institucionale të Gjirokastrës si qendër rajonale.

3.3 Propozimi specifik: zgjedhja e administratorëve të njësive administrative

Dashnor Aliko argumentoi dhe solli një propozim konkret për tu konisderuar:

- Aktualisht, administratori i njësive administrative emërohet nga kryetari i bashkisë dhe mund të shkarkohet pa asnjë kufizim ligjor, duke e kthyer në 'rogëtar' politik.
- Propozimi konkret: ligji i ri për njësitë vendore duhet të parashikojë zgjedhjen me votë të drejtpërdrejtë të kryetarit të njësive administrative.

Kryetari Golemi e vlerësoi pozitivisht rolin e administratorëve të angazhuar (duke cituar rastin e Mimoza Shëngjergji/Odrjes), por nuk e mbështeti eksplicit zgjedhjen me votë, duke evidentuar kështu një tension mes efikasitetit administrativ dhe llogaridhënies demokratike.

4. Financat vendore

Financat vendore u trajtuan me interes të veçantë, sidomos nga kontribuesit teknikë. Sesioni prodhoi propozime operative konkrete që tejkalojnë nivelin diagnostik.

4.1 Transferta qendrore: pamjaftueshmëria dhe formula

- Raporti 1% PBB vs. 14% BE u citua nga bashkëkryetari Boçi si tregues kyç i pabarazisë financiare strukturore. Mesatarja europiane nënkupton se bashkitë europiane marrin 14 herë më shumë si % e ekonomisë kombëtare sesa bashkitë shqiptare, e pamundur të kompensohet vetëm me reformë territoriale.
- Formula aktuale e granteve bazohet kryesisht mbi numrin e popullsisë. Kryetarja e Bashkisë Përmet, Alma Hoxha, propozoi shtimin e një koeficienti rural-territorial: 90% e territorit të Përmetit është rural, por formula nuk e pasqyron këtë kosto reale të shërbimit. Ky propozim është i verifikueshëm dhe ka efekte direkte redistributive.

4.2 Propozime operative specifike

Transferta e pakushtëzuar e integruar

Alma Hoxha propozoi që transferta për funksionet e deleguara të mos jetë instrument i veçantë, por të integrohet si pjesë e transfertës së pakushtëzuar, duke i dhënë bashkive fleksibilitet për të vendosur vetë prioritetet. Ky propozim do të ndryshonte strukturërisht mënyrën e alokimit të fondeve dhe kërkon konsultim me legjislacionin e financave vendore.

Sistemi i unifikuar i taksave vendore

Alma Hoxha evidentoi fragmentimin e informacionit tatimor: të ardhurat nga renta minerale, DRSH dhe DPSHTR-ja vijnë si shkresa të ndara, pa akses sistematik. Ajo propozoi ndërtimin e një sistemi të unifikuar të taksave vendore (analogjik me AFMIS-in për buxhetin), duke i dhënë bashkive akses transparent dhe në kohë reale mbi burimet e tyre tatimore.

Bashkia të mbledhë taksat drejtpërdrejt

Avokati nga Tepelena propozoi autonomizimin fiskal strukturor: taksat dhe tarifat vendore (aktualisht mbledhura nga degët tatimore dhe transferuara në buxhetin e shtetit e pastaj të bashkia) të mbledhen drejtpërdrejt nga bashkitë. Argumenti: rruga e gjatë e taksave redukton autonominë financiare vendore dhe vonon llogaridhënien ndaj tatimpaguesit vendor.

Formula popullsi + sipërfaqe

Ish-zyrtari i pushtetit vendor me eksperiencë të gjatë propozoi reformimin e formulës së granteve duke integruar dy variabla: numrin e popullsisë dhe sipërfaqen territoriale. Ai argumentoi se bashkia është e detyruar t'i shërbejë territorit, pavarësisht densitetit të popullsisë dhe formula aktuale e ndëshkon bashkitë me sipërfaqe të madhe dhe popullsi të shpërndarë (si Memaliaj, Përmet, Këlcyrë).

Formula specifike për Gjirokastrën

Anëtari i këshillit bashkiak (aksioner i ujësjellësit) propozoi formulën e financimit të mbështetur mbi profilin e bashkisë, jo vetëm popullsinë. Rasti i Gjirokastrës: me rreth 400.000 vizitorë të huaj në vit dhe mbi 1.000 monumente UNESCO, kostot e mirëmbajtjes së rrugëve, çative dhe ambienteve kulturore janë mesatarisht shumë më të larta se bashkitë e profil normal. Formula aktuale nuk e kap ngarkesën reale të shërbimit në bashkitë me trashëgimi kulturore intensive.

4.3 Buxhetet e bashkive: performancë e diferencuar

Dëgjesa eidentoi diferenca të ndjeshme mes bashkive të qarkut:

- Bashkia Përmet: të ardhurat vendore janë dyfishuar, nuk ka probleme financiare akute. Kryetarja Alma Hoxha e paraqiti si rast relativisht pozitiv, por me kufizime strukturore (90% territor rural i paçmuar nga formula aktuale).
- Bashkia Gjirokastrë: mbart akoma detyrime të prapambetura nga 7 ish-komunat e integruara. Drejtoresha e financës Artiste Koko argumentoi se këto detyrime nuk janë faj i bashkisë aktuale, reforma territoriale ua transferoi bashkisë borxhet e ish-komunave pa burime financiare adekuate shoqëruese.
- Bashkia Memaliaj: i gjithë buxheti i kryetarit Malaj është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e 53 fshatrave. Ai argumentoi se pa bashkinë, edhe qyteti i Memaliajt do braktisej, bashkia si punëdhënës është faktor kohezionist demografik.

5. Divergjenca e qëndrimit: zyrtarë aktualë dhe zëra të tjerë

Gjirokastra eidenton dinamikën pozicionale të parashikuar nga metodologjia, por me disa nuanca specifike për këtë qark.

5.1 Zyrtarët aktualë: mbrojtje e modelit, jo e status quo-s

Kryetarët e bashkive të pranishëm (z. Flamur Golemi — Gjirokastrë; z. Albert Malaj — Memaliaj; znj. Alma Hoxha — Përmet) ndanë karakteristika të përbashkëta, por me diferencime të rëndësishme:

- Z. Golemi mbrojti bashkitë e mëdha me argumentin e kapaciteteve, duke pranuar nevojën e reformës së kompetencave. E paraqiti ujësjellësin si shembull ku bashkia mund të ofrojë më mirë, por pa shkuar deri tek propozimi konkret i ri-komunalizimit.
- Z. Malaj mbrojti pavarësinë e Memaliajt, dhe nevojne për një autonomi financiare më të madhe.
- Znj. Alma Hoxha prodhoi kontributet teknikisht më të sofistikuara të sesionit (formula grantet, AFMIS, koeficienti rural) duke pranuar njëkohësisht efekte pozitive të reformës dhe kufizime reale.

E përbashkëta: asnjë kryetar bashkie nuk propozoi bashkime të reja apo reduktim të numrit të bashkive dhe asnjë nuk e quajti reformën 'dështim' pa kualifikim.

5.2 Ish-zyrtarët, qytetarët dhe shoqëria civile: diagnoza kritike

Zërat pa funksion aktual prodhuan diagnostikën më kritike dhe propozimet territoriale më radikale:

- Ish-kryetari i komunës Aliko: diagnoza e sistemit shëndetësor, propozimi i votës për administratorët, shifra konkrete mbi vadietjen. Kontribut me densitetin analitik më të lartë të sesionit.
- Mësuesi Xhaferaj (Këlcyrë): dëshmi direkte nga terreni rural, pro rikthimit komunave si perspektivë e pazëvendësueshme nga pozicionet institucionale.
- Gazetari dhe aktivisti Serjani: eidentoi mungesën e dimensionit kulturor nga diskursi institucional, duke argumentuar se turizmi si shtylla kryesore ekonomike kërkon edhe qasje trashëgimie.

- Qytetari emigrant Teorat Islami (nga një fshat 30 km nga Gjirokastra): shumë pak shërbime bashkiake teksa kemi taksë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi si rast i ndarjes mes detyrimit fiskal dhe shërbimit real.

6. Pikat e konvergencës

Pavarësisht ndarjeve të theksuara, sesioni prodhoi konvergjenca të dallueshme:

- Gjirokastra duhet të mbetet qendër administrative rajonale: konsensus ndër-palë, ndër-bashki dhe ndër-pozicional. U shpreh nga kryetari i këshillit bashkiak të Gjirokastrës (Brahimi), këshilltari i Dropullit (Kuremeno), gazetari Serjani dhe ish-prefekti Kote. Edhe kryetari Golemi e përforcoi implicitisht.
- Disa prej kompetencave të kryetarëve të bashkive janë të reduktuara pjesërisht me disa vendime të fundit: u pranua si e vërtetë edhe nga zyrtarët aktualë edhe nga kritikët. Diferenca qëndron në shkaqe (territore shumë të mëdha vs. centralizim nga qeveria qendrore), jo në diagnozë.
- Niveli rajonal/qark duhet forcuar me kompetenca reale dhe me llogaridhënie demokratike: propozimi doli nga spektri i gjerë si ish-prefektët, deputetët. Dallimet: mbi modelin (kryetar i zgjedhur vs. delegim qeveritar) dhe perimetrin (qark ekzistues vs. rajon i ri).
- Formula e granteve duhet reformuar duke integruar territorin si variabël: konvergjenca mes kryetares së Përmetit (propozim teknik specifik), ish-zyrtarit me eksperiencë të gjatë (propozim popullsi + sipërfaqe).
- Administratorët e njësive administrative duhet të kenë status dhe llogaridhënie më të forta: propozimi i zgjedhjes me votë (Aliko) nuk u kundërshtua eksplicit, edhe pse kryetari Golemi nuk e mbështeti plotësisht.
- Autonomia financiare reale, jo formale, si parakusht: konsensus i gjerë. Bashkitë nuk mund të ushtrojnë funksionet pa burime adekuate; formulimet variojnë (TVSH, renta, taksa direkte) por qëllimi është i njëjtë.

7. Mesazhet kyçe analitike

M1 — Gjirokastrë si paradoks i reformës

Qarku i Gjirokastrës paralajmëron një sfidë të reformës AT: ka numrin 'ideal' të bashkive sipas standardit evropian (argument i ngritur nga bashkryetari Boci), por asnjëra prej tyre nuk ka kompetencat dhe financat për t'i ofruar shërbimet që standardi evropian i shoqëron atij numri. Kjo do të thotë se modeli numerik mund të jetë i saktë, por plotësimi i tij strukturor nuk ka ndodhur.

M2 — Identiteti komunitar është argument institucional, jo thjesht emocional

Ndryshe nga Lezha, ku identiteti komunitar doli kryesisht si ndjenjë, në Gjirokastrë u argumentua me funksione konkrete: turizmi dhe trashëgimia (Gjirokastrë), bujqësia dhe blegtorisë (Libohova), demografia dhe ekonomia vendore (Memaliaj), statusi kushtetues i minoritetit (Dropull). Reforma duhet t'i trajtojë këto si variabla institucionale, jo si retorikë identitare.

M3 — Administratorët e njësive administrative janë hallka e patrajtuar

Propozimi i zgjedhjes me votë të administratorëve të njësive administrative, i cili ndërhyr në hendekun demokratik mes bashkive dhe komuniteteve fshatare, doli si kontributi më konkret dhe

potencialisht me impakt më të lartë i sesionit. Ai meriton trajtim të veçantë pavarësisht nga ndryshimet territoriale.

M4 — Financimi sipas profilit, jo vetëm popullsisë

Bashkia e Gjirokastrës si qytet UNESCO me 400.000 vizitorë/vit ka kosto mirëmbajtjeje strukturisht më të larta se bashkitë me profil normal. Bashkia e Përmetit me 90% territor rural ka kosto shërbimi shumë të ndryshme nga bashkia urbane. Formula aktuale uniforme i ndëshkon të dyja. Propozimi i koeficientit të profilit bashkiak është teknikisht i verifikueshëm dhe politikisht i pranueshëm ndërmjet palëve.

8. Çështje të hapura dhe prioritete studimore

Dëgjesa nxori çështje konkrete që kërkojnë studim ose vendimmarrje të mëtejshme:

- Rishikimi i statusit dhe metodës së zgjedhjes së administratorëve të njësive administrative, propozim me konsensus të gjerë latent, pa kundërshtim të shprehur.
- Ndërtimi i koeficientit të profilit bashkiak (turizëm/trashëgimi, territor rural, lartësi) në formulën e granteve, propozim teknik specifik i Bashkisë Përmet dhe i konfirmuar implicitisht nga disa folës.
- Statusi i minoritetit grek dhe uniteti territorial. Kushtetuta e detyron, por ndarja aktuale midis dy qarqeve nuk e respekton. Kjo kërkon vëmendje kushtetuese, jo vetëm administrative.
- Modeli i rajonit: kryetar i zgjedhur me votë apo i deleguar? Çështje e diskutueshme me argumente të forta nga të dyja anët; kërkon studim krahasues (modeli grek, italian, gjerman).
- Taksimi i trashëgimisë: taksa e kalasë vs. taksa e muzeut, kërkon trajtim të mëtejshëm.
- Reforma e sektorit bujqësor: riintegrimi institucional i shërbimeve të fragmentuara (veterinerë, agronomë, bordi i kullimit) nën autoritet vendor, çështje me impakt ekonomik të lartë dhe të patrajtuar nga politikat aktuale.
- Kapaciteti i bashkive të vogla për funksione komplekse: studim i fizibilitetit për bashkëpunim ndërbashkiak si alternativë ndaj bashkimeve.

Shënim metodologjik

Ky dokument është hartuar mbi bazën e transkriptit të plotë të minutave të takimit të sesionit të Gjirokastrës (24 Prill 2026), duke aplikuar metodologjinë e standardizuar të hartuar pas pilotimit të Lezhës. Ai përfaqëson të gjithë zërat e shprehur gjatë sesionit duke ruajtur balancimin mes qasjeve divergjente. Nuk shpreh qëndrimin zyrtar të Komisionit. Shifrat e cituara nga folësit (popullsi, buxhete, sipërfaqe, tregues performancë) trajtohen si deklarata të pjesëmarrësve dhe kërkojnë verifikim nga burime primare (INSTAT, MFE, raportet e bashkive) para përdorimit në dokumentet finale të komisionit. Transkripti i plotë dhe ky raport do të jenë publike në faqen e Kuvendit.